

04.03.2002

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

UNMIK
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА ASSEMBLY OF KOSOVO

MBLEDHJA E SEANCËS PLENARE

Mbledhja e Kuvendit të Kosovës filloj në ora 11 dhe u kryesua nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës Nexhat Daci i cili pas hapjes lajmëroj se me 28 janar nga grupi i dytë parlamentar nga PDK –ja kanë ardhur emrat e dy anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

- a - Xhavit Haliti
- b - Hydajet Hyseni

Pastaj Nexhat Daci duke u bazuar në kornizën kushtetuese ftoj deputetët të votojnë për anëtarët e ri të kryesisë së kuvendit. Gjatë këti votimi nuk pat vota kundër as apstenime të gjith ish-in për përveq KP të cilët nuk votuan.

Me këtë rast u zgjedhen edhe dy antarët e Kryesisë, e cila tani është e kompletuar me shtatë anëtar.

Nexhat Daci pasi është arritur marrveshja në mes të Kryetarve të tri partive politike pra LDK, PDK, AAK dhe në të cilën marrveshje pati rol të posaqëm edhe PSSP Michael Steiner ftoj Michael Steinerin që të thot disa fjal lidhur me këtë marrveshje.

Z. Steiner tha se kjo marrveshje është një themel për një të ardhme më të mirë për Kosovën dhe për popullin e saj dhe se ishte e mbështetur edhe nga Kofi Anan. Pastaj z. Steiner ceku se në bazë të kësaj marrëveshje z. Ibrahim Rugova nga LDK do të jetë Kryetar i Kosovës, z. Bajram Rexhepi nga PDK do të jetë Kryeministër i Kosovës si dhe do të ket edhe dhjet Ministra prej të cilëve vetëm koalicioni Kthimi nuk e ka caktuar emrin.

Z. Steiner njoftoj se të drejtë shkarkimi të Ministrave do të ketë vetëm PSSP. Në vazhdim z Daci ftoj deputetët të votojnë për marrveshjen dhe se votimi do të jetë i hapur, si dhe do të votohet në pako pra do të votohet për Kryetarin Kryeministrin dhe Ministrat.

Votimi në pako u kundërshtua nga Gojko Saviq pjestar i Koalicionit Kthimi sepse votimi në pako ishte në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese. Zt. Daci ftoi deputetët të votonin se kush ishte për votimin e marrëveshjes në pako:

Pas votimit ishin këto rezultate:

88 - vota për

15 - apstenime

3 - vota kundër

KP-nuk votuan

Pas votimit z Daci aprovoi:

Ibrahim Rugova - Kryetar i Kosovës (LDK)

Bajram Rexhepi – Kryeministër i Kosovës (PDK)

Ministrat:

1. Ministër i ekonomisë dhe financave Ali Sadria (LDK)
2. Ministër i tregëtisë dhe industrisë Ali Jakupi (PDK)
3. Ministër i arësimit shkencës dhe teknologjisë Regjep Osmani (LDK)
4. Ministër i kulturës rinisë dhe sportit Behgjet Brajshori (LDK)
5. Ministër i mjedisit dhe planifikimit hapsinor Ethem Çeku (AAK)
6. Ministër i punës dhe i mirqenjes sociale Ahmet Isufi (AAK)
7. Ministër i transportit dhe i komunikacionit Zef Morina (LDK)
8. Ministër i shërbimeve publike Jakup Krasniqi (PDK)
9. Ministër i bujqësis ,pylltaris dhe i zhvillimit rural Nuk e kanë të gatshëm emrin (KK)
10. Ministër i shëndetsisë Numan Baliq (VATAN)

Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci pas përshëndetjes dhe urimit për detyren të të gjithë këtyre përfundoi seancën

SHËRBIMI JURIDIK I KUVENDIT

04.03.2002
PRISHTINË